

D E K R E T
Nr.1465/1, datë 12.4.1996

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.8041, DATË 30.11.1995 “PËR MIRATIMIN ME
NDRYSHIME TË DEKRETIT NR.1274, DATË 9.11.1995 “PËR DISA SHITESA E
NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7936, DATË 18.5.1995 “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN
NR.7609, DATË 22.9.1992 “PËR TARIFAT DOGANORE”**

Në mbështetje të nenit 28, pika 19, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

D E K R E T O J:

Neni 1

Në ligjin nr.8041, datë 30.11.1995, në fund të paragrafit të dytë të nenit 1 shtohet:
“Përjashtohen nga taksa doganore gjithashtu të gjitha llojet e kazanëve a rezervuarëve, në të cilët depozitohet e ruhet gaz i lëngët, pajisjet e mjetet teknologjike që shërbejnë e përdoren për mbushjen, transportimin ose shpërndarjen e gazit të lëngët e të bombolave”.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

KUNDËRFIRMOHET

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Mexsi

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Sali Berisha